



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN

01 Nr. / Br 172/21  
Nr. i fq. / Br. st - 3 -  
Data: / Datum 15. 07. 2021  
VUSHTRRRI - VUČITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA VUSHTRRRI  
OPŠTINA VUCITRN

### PROCESVERBAL

nëga mbledhja e V-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më  
11 qershor 2021 në sallën e kryetarit të komunës, e cila filloj në ora 14:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Melihate Basholli-Latif, Gresa Muli, Ymer Haradinaj, Shkëlzen Feka, Arta Ymeri, Nezir Klinaku dhe Teuta Aruci Shartari (anëtarë të KPF-së).

Mungoi: Shpëtim Zhegrova.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Arta Ismajli, Xhavit Mehmeti zyrtar në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe nga sekretaria e kuvendit Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së** – tha se një grup i studentëve e kanë dërguar një kërkesë në Zyrën e Kryetarit dhe në Drejtorinë për Arsim lidhur me zgjatjen e orarit të leximit në bibliotekën e Vushtrrisë. Prandaj, ai kërkoi që kjo pikë të futet në rend të ditës për të diskutuar dhe ta procedohet në kuvend.

**Arta Ismajli, Drejtoreshë e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport** – deklaroi se ajo kërkesë apo peticion që ka shkuar te kryetari, ka mjaftuar që të vjen vetëm si kërkesë në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe jo te Drejtoria për Arsim e as te Kryetari i Komunës, sepse biblioteka është kompetencë e kësaj drejtorie. Është fakt që biblioteka nuk po punon me orar të zgjatur, sepse ata janë në një objekt tjetër, e jo në qendrën e kulturës. Është në procedurë inventarizimi i qendrës së kulturës dhe bibliotekës. Biblioteka nuk është pajisur me inventar adekuat, i cili do ta mundëson edhe zgjatjen e orarit. Por, pasi që edhe nuk ka staf të mjaftueshëm në bibliotekë, drejtoria ka mundësi që deri në ora 18:00 ta mbajë hapur bibliotekën, por vetëm duhet të presim deri të vjen inventari dhe nuk ka asnjë arsyë tjetër.

*Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:*

### R E N D D I T E

- Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 17 maj 2021;
- Shqyrtimi i Draft Kornizës Afatmesme (KAB) për vitet 2022-2024;
- Shqyrtimi i Informatës rrëth procedurës së legalizimit të objekteve;

4. Shqyrtimi Informatës për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2020/2021;
5. Shqyrtimi i Draft-Planit të Trashëgëmisë Kulturore 2021-2023;
6. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Ndërmarrjes regionale të ujësjellësit “Mitrovica”;
7. Të ndryshme.
  1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 17 maj 2021.

*Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 17 maj 2021.*

2. Shqyrtimi i Draft Kornizës Afatmesme (KAB) për vitet 2022-2024.

**Nasuf Aliu, kryesues i KK-së dhe i KPF- së** –lidhur me këtë e kemi një informatë nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa që ende nuk është kompletuar.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

3. Shqyrtimi i Informatës rrëth procedurës së legalizimit të objekteve.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

4. Shqyrtimi Informatës për ndarjen e bursave dhe shpërblimet e nxënësve për vitin 2020/2021

**Melihate Basholli Latifi, anëtar e KPF-së** – theksoi se mund të bëjmë diskutim sipërfaqësor, sepse materiali sa po na erdhi. Tek drejtimi i matematikës që nuk është ndarë asnjë bursë dhe janë planifikuar që të ndahen dy bursa, nëse kanë mbetur mjete financiare, atëherë do të ishte mirë që të shpallet prapë konkursi dhe këto mjete mos të destinohen diku tjeter, por vetëm në dorë të studentëve.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

5. Shqyrtimi i Draft-Planit të Trashëgëmisë Kulturore 2021-2023.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – pyeti se a ka munduar Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport që ish – objektin e gjykatës ta fus në trashëgimi kulturore?

**Xhavit Mehmeti, zyrtar nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport** – deklaroit se është pyetje politike dhe se në këtë moment nuk mund të jap përgjigje.

Ky është një dokument që është punuar nga komuna në bashkëpunim me shoqërinë civile. Është një kontinuitet i drejtoreshës së kaluar dhe drejtoreshës aktuale. Pandemia dhe forma e konsultimit publik që ka ndërruar na ka vonuar paksa lidhur me këtë dokument. Ky dokument është prodhim vendor dhe nuk është kopjuar nga asnjë komunë. Jemi munduar që ta bëjmë sa më të thjeshtë. Nuk them që është dokumenti më i mirë, por në të ardhmen mund të plotësohet apo

ndryshohet. Jemi munduar të paraqesim gjëra sa më reale dhe konkrete. Qëllimi kryesor është promovimi dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore, theksoi Mehmeti. Ai tha se ky dokument është bërë me 200 euro, me një ekspert të jashtëm dhe me angazhim të stafit nga drejtoria dhe shoqërisë civile.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

6. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Ndërmarrjes regionale të ujësjellësit “Mitrovica”.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – deklaroi se kjo duhet të vjen si informatë, e jo si raport. Prandaj, unë nuk marr pjesë në votim të rapportit të ndërmarrjes kur nuk e dimë se çka punohet atje.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së** – tha se si komunë kemi investuar për kyçjet në ujësjellës të ekonomive familjare. Plani ka qenë që mbi 9000 ekonomi familjare të kyçen në ujësjellës, ku shumica prej tyre veç janë kyçur e disa janë në proces. Para dy jave kam pasur një takim me përfaqësues të kësaj ndërmarrjeje. Ata ishin të autorizuar nga ndërrmarja që të monitorohen punimet, pastaj të kërkohet pagesa nga ekonomitë familjare për kyçje. Prandaj, në mbledhjen e kuvendit duhet të jetë i pranishëm një përfaqësues nga ndërrmarja që diskutohen këto çështje dhe kur të bëhet pranimi teknik të jenë të pranishëm përfaqësuesit e ndërmarrjes, të komunës dhe përfaqësuesit e fshatrave.

7. Të ndryshme.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – tha se e ka parë në rrjete sociale disa foto se KEDS-i në një fshat të Komunës së Vushtrrisë i ka vendosur shtyllat elektrike në mes të rrugës. Ai pyeti se a është kjo e vërtetë, apo ka ndonjë qëllim. Nëse nuk ka qenë fotografi montazhë, kjo është shqetësuese.

**Ymer Haradinaj, anëtar i KPF-së** – punëtorët e pastrimit dhe të sigurimit ende nuk kanë marrë paga. Ai tha se në bazë të disa informacioneve që kam dëgjuar, Bordi i Drejtoreve të NPL “Përparimi” nuk qenka zgjedhur në bazë të ligjeve. Andaj, kërkoj informatë se deri ku ka shkuar procedura dhe cila është arsyja që ata punëtorë ende nuk i kanë marrë pagat e tyre.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

Mbledhja përfundoi në orën 14:35.

Bujar Klinaku

*B. Klinaku*  
Procesmbajtës

Nasuf Aliu

*N. Aliu*  
Kryesues i KK-së dhe i KPF-së

